REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA /
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA - VLADA - GOVERMENT
MINISTRIA E EKONOMISE
MINISTARSTVO EKONOMIJE
MINISTRY OF ECONOMY
Njesia Org: Org. Jedin Org Unit 01/3
Nr. Prot. Br. Prof Prof.No: 2096
Data: Datum: Date: 02.11.26

KOMPANIA RAJONALE E UJËSJELLËSIT
SH. A. PEJË

HIDRODRINI

Zyret qendrore
Rr. Lekë Dukagjini Nr. 156 30000 Pejë
Telefoni: 039 / 432 355
www.hidrodrini.com


Në bazë të Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike ligji nr.03/L-087, i ndryshuar dhe i plotësuar më ligjet, nr.08/L-276, nr.04/L-111, dhe numër 05/L-009, nenit 14 paragrafi 2.2 të Statutit të K.R.U. "Hidrodrini" Sh. A., Pejë, Bordi i Drejtorëve në mbledhjen e mbajtur me 28.10.2026, shqyrtoi Planin e Biznesit për vitin 2027 dhe njëzëri, mori vendim për aprovimin e tij.

Vendim: Nr.35/2026

Plani i Biznesit 2027 i K.R.U "Hidrodrini" SH.A.,Pejë

	Delegoi	Aprovoi
Emri dhe Mbiemri	Dri Cena Kryeshef Ekzekutiv	Qendresa Kukaj Kryesuese e Bordit të Drejtorëve
Nënshkrimi		
Data	28.10.2026	28.10.2026

KOMPANIA RAJONALE E UJËSJELLËSIT HIDRODRINI SH.A. PEJË



PLANI I BIZNESIT 2027

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA /
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA - VLADA - GOVERMENT
MINISTRIA E EKONOMISË
MINISTARSTVO EKONOMIJE
MINISTRY OF ECONOMY
Njësia Org.
Org. Jedin
Org Unit 01/3
Nr. i faqeve
Broj stranica
No. pages
Nr. Prot. 2096
Br. Prot
Prot.No:
Data:
Datum: 02.11.26
Date:
PRISHTINË/A
NO.1

HIDRODRINI

Kompania Rajonale e Ujësjellësit "HIDRODRINI" Sh.A.

Periudha strategjike: 2027–2029

Pejë, 2026

Përmbajtja

1. Përmbledhje ekzekutive 6
2. Të dhënat e kompanisë 7
2.1 Njësia operative e ujësjellësit – NJO Qëndrore 9
2.2 Njësia operative e ujësjellësit – NJO Istog 10
2.3 Njësia operative e ujësjellësit – NJO Klinë 11
2.4 Njësia operative a ujësjellësit – NJO Deçan 13
2.5 Njësia operative e ujësjellësit – NJO Junik 15
3. Metodologjia dhe baza ligjore 16
3.1 Metodologjia e përpilimit 16
3.2 Baza ligjore me ndikim të drejtpërdrejtë 17
4. Misioni dhe vizioni 18
4.1 Misioni 18
4.2 Vizioni 18
5. Qëllimet dhe objektivat strategjike 2027–2029 18
5.1 Përmbledhje e objektivave strategjike dhe aktiviteteve 18
5.2 Objektivi strategjik 1 — Zvogëlimi i humbjeve të ujit 20
5.3 Objektivi strategjik 2 — Reduktimi i llogarive të arkëtueshme dhe rritja e inkasimit 21
5.4 Objektivi strategjik 3 — Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit 22
5.5 Objektivi strategjik 4 — Zgjerimi i rrjetit të kanalizimit 23
5.6 Objektivi strategjik 5 - Zhvillimi i burimeve njerëzore 24
6. Performanca 2026 dhe planifikimi 2027 26
6.1 Performanca operative dhe financiare 26
7.1 Rrjeti dhe mbulueshmëria 30
7.2 Tarifat e shërbimit për vitin 2027 32
8. Impiantet e ujit të pijshëm dhe trajtimi i ujërave të ndotura 36
8.1 Impianti i Trajtimit të Ujit të Pijshëm dhe fundërruesi — Klinë 36
8.3 Fazat e trajtimit 39
8.4 Aspektet operacionale 40
9. Departamenti Teknik dhe GIS 41
9.1 Roli dhe organizimi 41
9.2 Objektivat teknike 42
9.3 Prodhimi i Ujit 42
9.4 Defektet në rrjetin e ujësjellësit 43
9.5 Sektori i GIS-it 45

10. Departamenti i Kualitetit të Ujit 50
10.1 Parametrat bakteriologjikë 51
10.2 Parametrat fiziko-kimikë 51
11. Departamenti Komercial 51
11.1 Faturimi, arkëtimi dhe inkasimi 52
11.2 Leximi i ujëmatësve 53
11.3 Arkat 53
11.4 Inspektorët 53
11.5 Qendra e thirrjeve (Call Center) 54
11.6 Zyra për kërkesa dhe ankesa 54
12. Departamenti Teknologjisë Informative 54
13. Departamenti Financiar 55
13.1 Pagesa e shpenzimeve dhe raportimi 56
13.2 Siguria financiare 56
13.3 Kontingjentet dhe detyrimet 56
13.4 Lista e Pronave në posedim dhe shfrytëzim 56
13.5 Buxheti vjetor për vitin 2027 70
14.INVESTIMET KAPITALE 77
14.1 Kontratat për furnizim 77
14.2 Kontratat për shërbime 78
14.3 Kontratat për punë nga investimet vetanake 79
14.4Rikapitullimi 80
14.5 Bashkëfinancimet me komunat 81
15. Projektet e propozuara për financim nga Ministria e Ekonomisë 81
15.1 Arsyetimet kryesore të projekteve 83
16. Shtojcat 84
Shtojca 1 — Skema organizative 84
Shtojca 2 — Analiza SWOT 85

Lista me fotografi dhe grafike

Fotografia 1. Harta e zonës së shërbimit të KRU “Hidrodrini” SH.A. 8
Fotografia 2. Harta e zonës së shërbimit të KRU “Hidrodrini” SH.A. – Komuna e Pejës 10
Fotografia 3. Harta e zonës së shërbimit të KRU “Hidrodrini” SH.A. – Komuna e Istogut 11
Fotografia 4. Harta e zonës së shërbimit të KRU “Hidrodrini” SH.A. – Komuna e Klinës 13
Fotografia 5. Harta e zonës së shërbimit të KRU “Hidrodrini” SH.A. – Komuna e Deçanit 14
Fotografia 6. Harta e zonës së shërbimit të KRU “Hidrodrini” SH.A. – Komuna e Junikut 16

Fotografia 7. Zona e shërbimit të KRU “Hidrodrini” Sh.A. – Burimet e ujit 28
Fotografia 8. Zona e shërbimit të KRU “Hidrodrini” Sh.A. – Burimet e ujit 2 29
Fotografia 9. Rrjeti i kanalizimit i ndarë në bazë të kolektorëve 30
Fotografia 10. Pamje e ITUP në Klinë 36
Fotografia 11. Pamje e brendshme e ITUP në Klinë 37
Fotografia 12. Fundërruesi 38
Fotografia 13. Pamje nga lartë e ITUN në Pejë 39
Fotografia 14. Pamje nga lartë i ITUN në Pejë - 2 41
Fotografia 15. Rrjeti i ujësjellësit sipas diametrit në të gjithë zonën e shërbimit të KRUH 44
Fotografia 16. Rrjeti i kanalizimit në të gjithë zonën e shërbimit të KRUH 45
Fotografia 17. WebGIS aplikacioni i ndërlidhur me SISHU 46
Fotografia 18. Raporti përmbledhës i prodhimit të ujit (m^3), i qasshëm përmes webGIS aplikacionit 47
Fotografia 19. Raporti përmbledhës i stacionit të pompimit (EUR dhe kW), i qasshëm përmes webGIS aplikacionit 47
Fotografia 20. Raporti përmbledhës i cilësisë së ujit (fiziko-kimike dhe mikro-biologjike), i qasshëm përmes webGIS aplikacionit 48
Fotografia 21. Konsumatorët sipas borxhit (EUR) i qasshëm përmes webGIS aplikacionit 48
Fotografia 22. Konsumatorët sipas kategorisë (amvisëri, biznes, etj), i qasshëm përmes webGIS aplikacionit 49
Fotografia 23. Konsumatorët sipas moshës së matësit (në vite), i qasshëm përmes webGIS aplikacionit 49
Fotografia 24. Konsumatorët sipas pagesës së fundit (në muaj), i qasshëm përmes webGIS aplikacionit 50

Lista me tabelat

Tabela 1. Prodhimi, faturimi, humbjet, shpenzimet dhe inkasimi 2023–2027 27
Tabela 2. Burimet e ujit 29
Tabela 3. Gjatësia e rrjetit të ujësjellësit sipas njësive. 31
Tabela 4. Asetet jo-infrastrukturore të KRU-së. 31
Tabela 5. Gjatësia e rrjetit të kanalizimit sipas njësive 32
Tabela 6. Tarifat volumetrike për vitin 2027 33
Tabela 7. Tarifa fikse mujore sipas diametrit të lidhjes. 33
Tabela 8. Tarifat për inspektim, ndërprerje dhe ri-lidhje 34
Tabela 9. Tarifat për realizimin fizik të lidhjes në rrjetin e ujësjellësit. 34
Tabela 10. Tarifat për realizimin fizik të lidhjes në rrjetin e kanalizimit. 35
Tabela 11. Testimi i ujëmatësit për sigurinë e matjes 35
Tabela 12. Tarifa e mbingarkesës së infrastrukturës, e zbatueshme nga 01 janar 2027 sipas letrës zyrtare të ARRU-së nr. prot. 7161/D, datë 20.10.2026 36
Tabela 13. Divizionet dhe Funksionet kryesore te departamentit teknik 42
Tabela 14. Kohëzgjatja e riparimit në bazë të diametrave 44
Tabela 15. Aktivitetet e departamentit komercial 52
Tabela 16. Aktivitetet dhe planifikimi i departamentit IT 55
Tabela 17. Detyrimet tatimore 56
Tabela 18. Planifikimi buxhetor për vitin 2027 - Performanca janar-qershor 71
Tabela 19. Planifikimi buxhetor për vitin 2027 – Performanca korrik-dhjetor 73
Tabela 20. Planifikimi buxheti për vitin 2027 – Raporti Faturim Inkasim 74
Tabela 21. Planifikimi buxhetor për vitin 2027 – Shpenzimet 74

Tabela 22. Caqet 2027-2029 76

Shkurtesat – Akronimet

ARRU - Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit
ASK - Agjensioni i Statistikave të Kosovës
BPRR - Biznes Planet Rregullatorë
BRRA - Baza Rregullatore e Aseteve
BD - Bordi i Drejtorëve
IKSHPK - Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës
IÇKK - Indeksi i Çmimit të Konsumit në Kosovë
KNMU - Këshillit Ndërministror për Ujëra
KRU - Kompania Rajonale e Ujësjellësit
KRUH – Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Hidrodrini"
NJPMNP - Njësia për Politika e Monitorim të Ndërmarrjeve Publike
QU - Qendra e Ujit
UPF - Uji i pa-faturuar
UA - Udhëzimi Administrativ
OSH - Ofruesit e Shërbimeve
SIG - Sistemi Informativ Gjeografik (GIS)
TKP - Treguesit Kyç të Përformancës
GNI - Grupi Ndërinstitucional
SHUKOS - Shoqata e Ujësjellësve dhe Kanalizimit të Kosovës
NJO - Njësia Operative
BV - Biznese të Vogla
BM - Biznese të Mëdha
ITUP - Impiant i Trajtimit të Ujit të Pijes
ITUN – Impianti i Trajtimit të Ujit të Ndotur
DMA - District meter area (Zona të matura)
ARKEP – Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
KOS-CERT – Njësia Nacionale për Siguri Kibernetike

1. Përmbledhje ekzekutive

Ky Plan i Biznesit paraqet orientimet, objektivat, aktivitetet dhe burimet e planifikuara të KRU "Hidrodrini" Sh.A. për vitin 2027, në kuadër të periudhës strategjike 2027–2029. Dokumenti synon të shërbejë si udhërrëfyes për menaxhimin, zbatimin dhe monitorimin e performancës së kompanisë.

Ky dokument është punuar duke u mbështetur në gjendjen aktuale dhe duke u mbështetur në trendët e zhvillimit të këtij sektori në vend dhe në regjion, duke adoptuar praktikat pozitive nga kompanitë e ndryshme me qëllim të arritjes së objektivave të përcaktuara nga menaxhmenti.

KRU "Hidrodrini" Sh.A. ofron furnizim me ujë të pijshëm dhe shërbime të kanalizimit në pesë komuna të regjionit të Pejës: Pejë, Istog, Klinë, Deçan dhe Junik. Kompania shërben rreth 186,000 banorë me ujë të pijshëm dhe rreth 77,000 banorë me trajtim të ujërave të ndotura. Kapaciteti prodhues i raportuar është rreth 47,733,713.02 m^3 në vit.

Prioritetet për vitin 2027 janë zgjerimi i mbulueshmërisë me ujë dhe kanalizim, përmirësimi i cilësisë së furnizimit, ulja e humbjeve të ujit, rritja e faturimit dhe inkasimit, mirëmbajtja e infrastrukturës, zhvillimi i zonave DMA, digjitalizimi i leximit dhe faturimit, si dhe forcimi i kapaciteteve njerëzore dhe teknike.


Kompania synon furnizim me ujë të pijshëm për mbi 99% të zonës së shërbimit, faturim deri në 98%, zgjerim të rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, si dhe rritje të arkëtimit përmes pagesave online, marrëveshjeve me konsumatorët, veprimeve inspektuese dhe procedurave ligjore ndaj borxhlinjve.


Planifikimi financiar për vitin 2027 përfshin të hyra dhe shpenzime të analizuara në mënyrë të decentralizuar nga njësitë operative drejt menaxhmentit, dhe si përfundim planifikimi ynë është që deri në fund të vitit 2027 të arkëtojmë deri në 6,600,700.99 euro, të cilat konsiderohet se janë të mjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve operative dhe nevojave investive për këtë periudhë planifikuese.

Plani përfshin investime në rezervuarë, rrjete, burime, pajisje operative, teknologji informative, laboratorë, mjete transporti dhe pajisje për mirëmbajtjen e kanalizimit. Zbatimi i këtij plani të biznesi do të mbështetet nga Bordi i Drejtorëve, menaxhmenti, departamentet përkatëse dhe pesë njësitë operative të kompanisë.

2. Të dhënat e kompanisë

Të dhëna	**Përshkrimi**
Emri	Kompania Rajonale e Ujësjellësit “Hidrodrini” Sh.A.
Forma dhe statusi	Shoqëri aksionare dhe ndërmarrje publike qëndrore nën mandatin e Ministrisë së Ekonomisë të Republikës së Kosovës.
Numri i biznesit	811336975
Zona e shërbimit	Komunat Pejë, Istog, Klinë, Deçan dhe Junik.
Shërbimet	E licencuar nga ARRU deri me datë 10.09.2031 me numër licence L-09/2026-03 për shërbimet sipas kategorive: A – Shërbimet e ujësjellësit B – Shërbimet e kanalizimit C – Shërbimet e ujerave të ndotura
Popullsia e shërbyer	Rreth 186,000 banorë me ujë të pijshëm dhe rreth 77,000 banorë me trajtim të ujërave të ndotura.
Kapaciteti prodhues	Rreth 47,907,779 m^3 në vit.
Njësitë operative	Pejë, Istog, Klinë, Deçan dhe Junik.
Selia	Pejë.





Fotografia 1. Harta e zonës së shërbimit të KRU "Hidrodrini" SH.A.


2.1 Njësia operative e ujësjellësit – NJO Qëndrore


Kjo njësi furnizon me ujë të pijes qytetin e Pejës dhe 49 fshatra përreth. Gjithë furnizimi me ujë të pijes bëhet nga dy burime kryesore: Burimi i Drinit të Bardhë dhe Burimi i Ujit të Zi, si dhe nga dy burime më të vogla: Burimi i Ujit të Bardhë dhe ai i Raushiqit. Nga burimi i Drinit të Bardhë i gjithë sistemi operon me gravitet, ku nga kjo pjesë furnizohet me ujë një pjesë e qytetit të Pejës, Lugu i Trestenikut dhe Lugu i Leshanit.

Nga burimi Uji i Zi, uji rrjedhë me gravitacion deri tek objekti i kompanisë ku pastaj ndahen tri sisteme:

1. Sistemi i gravitetit që furnizon një pjesë të qytetit të Pejës;
2. Sistemi i pompave shtytëse që po ashtu e furnizon një pjesë të qytetit të Pejës dhe vazhdon deri në fshatin Bellopojë.
3. Sistemi i pompave të reja që shtynë ujin në rezervuarin 3000 m³ dhe nga i cili furnizohen me ujë pjesët më të larta të qytetit të Pejës.

Njësia Operative Pejë ka dy stacione kryesore të pompimit dhe 18 stacione tjera ndihmëse. Me dy depo të ujit të pijshëm me rreth 1500 m³ dhe 3000 m³, 467km' rrjet i ujit me tubacione të profileve të ndryshme, dy stacione të klorinimit, 211km' rrjet i kanalizimit dhe Impianti i Trajtimit të Ujërave të Ndotura me kapacitet për 81.000 banorë.






Fotografia 2. Harta e zonës së shërbimit të KRU "Hidrodrini" SH.A. – Komuna e Pejës


2.2 Njësia operative e ujësjellësit – NJO Istog

Burimet kryesore që furnizojnë komunën e Istogut dhe fshatrat përreth janë:

1. Burimi i Istogut,
2. Burimi i Vrellës dhe
3. Burimi i Kosharishtes dhe Vojdullit.

Kjo Njësi Operative furnizon me ujë të pijes qytetin e Istogut dhe 46 fshatra përreth. Posedon 8 depo (rezervuare) të ujit me kapacitet 700 m³, 400 m³, 400 m³, 800 m³, 500 m³, 200 m³, 400 m³, 400 m³, 7 stacione të pompimit dhe 5 stacione të klorinimit.






Fotografia 3. Harta e zonës së shërbimit të KRU "Hidrodrini" SH.A. – Komuna e Istogut


2.3 Njësia operative e ujësjellësit – NJO Klinë

Burimi i ujit Jarinë furnizon me ujë qytetin e Klinës dhe disa fshatra. Fabrika ka një kapacitet prodhues prej 310 m^3ëorë (86.1 lës), por meqenëse uji që vjen nga puset është në një sasi më

të vogël dhe uji i basenit të hapur është me turbullirë të lartë. Prodhimi i ujit varet nga turbullirat e ujit të lumit Drini i Bardhë.

Kjo njësi operative furnizon me ujë të pijes qytetin e Klinës dhe rreth 25 fshatra për rreth. Kjo njësi operative përfshin stacionin e klorinimit në qytet dhe në fshatra, katër Depo të ujit me kapacitet prej1000m3, 800m3, 400m3, 400m3 dhe 50m3, një rrjet prej 264km gyp sjellës të ujit, dy Stacione kryesore të pompimit, një Impiant të ujitë të pijshëm, dhe 138km rrjetë të kanalizimit.







Fotografia 4. Harta e zonës së shërbimit të KRU "Hidrodrini" SH.A. – Komuna e Klinës

2.4 Njësia operative a ujësjellësit – NJO Deçan

Në njësinë e Deçanit i gjithë sistemi i furnizimit me ujë është me gravitet. Qyteti i Deçanit dhe fshatrat për rreth furnizohen me ujë nga disa burime dhe atë nga burimet kryesore që vijnë në rezervuarin tek zyrat e KRU Hidrodrinit furnizohet Deçani, ndërsa janë dhe sistemet e ashtuquajtura ai i Isniqit, Strellcit, CDF-it dhe sistemi i 10 fshatrave që merr ujin në vendin e ashtuquajtur Gurrat e Hasan Agës Ekzistojnë gjashtë depo (rezervuar) me Kapacitet prej: Coopi 530m³, Nca 508m³, Strellc 720m³, dhe CDF. Të gjitha pikat janë të pajisura me klorinator.





Fotografia 5. Harta e zonës së shërbimit të KRU "Hidrodrini" SH.A. – Komuna e Deçanit


2.5 Njësia operative e ujësjellësit – NJO Junik


Komuna e Junikut me disa fshatra përreth furnizohet nga dy burime kryesore:

1. Burimi i Gocit nga bjeshkët e Junikut dhe
2. Burimi i Shkozës

I gjithë sistemi i furnizimit me ujë është sistem me gravitet. Në këtë njësi janë dy rezervuare me kapacitet 500m³ dhe 35m³ dhe dy stacione të klorinimit, ndërsa gjatësia e rrjetit është 41km'.

Njësia e Junikut ka edhe ITUN, i ndërtuar vite më parë nga një donacion nga Bashkimi Evropian, mirëpo është shoqëruar me disa probleme të natyrave të ndryshme teknike dhe pronësore.





Fotografia 6. Harta e zonës së shërbimit të KRU "Hidrodrini" SH.A. – Komuna e Junikut

3. Metodologjia dhe baza ligjore

3.1 Metodologjia e përpilimit

Plani i Biznesit 2027 është hartuar në përputhje me detyrimin ligjor për ndërmarrjet publike dhe mbi bazën e analizës së gjendjes ekzistuese socio-ekonomike, rezultateve të viteve paraprake, trendëve të sektorit të ujit në Kosovë dhe rajon, si dhe praktikave financiare, teknike dhe teknologjike të përshtatshme për kompaninë.

Në procesin e hartimit janë marrë në konsideratë rezultatet e vitit 2026, pritjet për vitin 2027, objektivat strategjike për periudhën 2027–2029, nevojat e njësive operative, kërkesat e konsumatorëve dhe konteksti ekonomik e socio-kulturor i Republikës së Kosovës.

Pas miratimit nga Bordi i Drejtorëve, plani duhet të zbërthehet në plane të detajuara të zbatimit, me përgjegjësi të përcaktuara, tregues të matshëm dhe raporte periodike të monitorimit.

3.2 Baza ligjore me ndikim të drejtpërdrejtë

Ndërmarrja Publike KRU "Hidrodrini" Sh.A. është e organizuar si shoqëri tregtare ku aksionar është Qeveria e Republikës së Kosovës. Veprimtaria e saj operative dhe financiare do të organizohet në atë mënyrë që të përmbushë detyrimet në zbatimin e akteve dhe dispozitave ligjore të miratuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës:

- Ligji për Ndërmarrjet Publike (nr.03/L-087); i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjet:
- Ligjit nr. 04/L-111 për Plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike;
- Ligji nr. 05/L-009 për Plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike
- Ligji nr.06/L-021 për Kontrollin e brendshëm të financave publike
- Ligji nr.06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim
- Ligji nr.06/L-016 për Shoqëritë Tregtare;
- Ligji për ujërat (Ligji nr.04/L-147);
- Ligji i Punës (Ligji nr. 03/L-212);
- Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë (Ligji nr. 03L-048); i plotësuar dhe ndryshuar me ligjet:
- Ligji nr. 03L-221 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03L-048 për menaxhimin e Financave publike dhe përgjegjësitë ;
- Ligji nr.04L-116 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësive;
- Ligji nr. 04L-194 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03L-048 për menaxhimin e Financave publike dhe përgjegjësitë, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjet nr. 03L-221 dhe nr. 04L-116;
- Ligji nr. 05L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03L-048 për menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjet nr. 03L-221, nr. 04L-116 dhe nr. 04L-194;
- Ligji nr. 05L-007 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03L-048 për menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjet nr.03L-221, nr.04L-116, nr. 04L-194 dhe nr. 05L-063;

- Ligji nr.05L-42 për rregullimin e shërbimeve të ujit: i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin nr.06L-088 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.05L-042 për rregullimin e shërbimeve të ujit.
- Ligji Nr.06L-082 për mbrojtjen e të dhënave personale.
- Ligji për Festat Zyrtare në Republikën e Kosovës (Ligji nr.03ëL-064).

---

4. Misioni dhe vizioni

4.1 Misioni

Misioni i KRU "Hidrodrini" Sh.A. është furnizimi me ujë të pijshëm, mirëmbajtja e rrjetit të ujësjellësit, mbledhja e ujërave të ndotura dhe trajtimi i tyre për banorët e regjionit të Pejës përmes pesë njësive operative. Kompania synon qasje dhe trajtim të barabartë për të gjithë konsumatorët, pa diskriminim racor, fetar, kombëtar ose gjinor.

Zbatimi i misionit mund të ndikohet nga (I) mungesa e ujit në burime si pasojë e mungesës së reshjeve atmosferike; (II) kriza sociale-ekonomike në nivel të vendit ose lokal, me ndikim në mosrealizimin e të ardhurave të gatshme; (III) mosgatishmëria e donatorëve potencial në financimin e projekteve investive të nevojshme; si dhe (IV) fatkeqësitë e pa pritshme natyrore.

4.2 Vizioni

Vizioni i KRU "Hidrodrini" Sh.A. është që deri në fund të vitit 2028 të sigurojë furnizim të pandërprerë me ujë të pijshëm gjatë 24 orëve për zonën e Pejës, Istogut, Deçanit, Klinës dhe Junikut, duke ulur humbjet e ujit, rritur arkëtimin, shfrytëzuar në mënyrë racionale burimet dhe mirëmbajtur rregullisht rrjetet e ujësjellësit dhe kanalizimit.

---

5. Qëllimet dhe objektivat strategjike 2027–2029

5.1 Përmbledhje e objektivave strategjike dhe aktiviteteve

Qëllimet strategjike të kompanisë janë ulja e humbjeve të ujit, reduktimi i llogarive të arkëtueshme, rritja e inkasimit, zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit dhe zgjerimi i rrjetit të kanalizimit.

Një nga prioritetet kryesore strategjike të KRU “Hidrodrini” Sh.A. është zvogëlimi i humbjeve të ujit dhe rritja e efikasitetit të menaxhimit të sistemit të furnizimit me ujë. Për këtë qëllim do të hartohen dhe zbatohen strategji dhe plane konkrete nga ekipet për menaxhimin e humbjeve të ujit, në bashkëpunim me inspektorët dhe ekipet mbështetëse në terren. Aktivitetet do të përfshijnë krijimin dhe menaxhimin e zonave DMA, identifikimin e kyçjeve ilegale dhe përdoruesve të paautorizuar, kontrollin e rrjetit dhe monitorimin e konsumit, si dhe investimet në zëvendësimin e gypave të vjetër dhe të dëmtuar.

Në funksion të digjitalizimit dhe rritjes së efikasitetit operacional, do të vazhdojë instalimi i ujëmatësve të mençur, të cilët mundësojnë leximin në distancë, matjen më të saktë të konsumit dhe identifikimin e keqpërdorimeve. Paralelisht, do të përmirësohet menaxhimi i presionit në rrjet përmes instalimit të frekuentuesve, pajisjeve të kontrollit dhe sistemeve SCADA, me synim reduktimin e avarive, humbjeve dhe kostove operative. Rritja e kapaciteteve profesionale përmes trajnimeve dhe angazhimi i tërë personelit do të jetë pjesë përbërëse e këtij procesi.

Një objektiv tjetër i rëndësishëm është rritja e inkasimit dhe përmirësimi i menaxhimit të llogarive të arkëtueshme. Për këtë do të forcohet bashkëpunimi me organet ligjore dhe institucionet kompetente, do të zbatohet një qasje e strukturuar për trajtimin e borxheve përmes vërejtjeve, ç’kyçjeve dhe procedurave përmbarimore, si dhe do të hartohen rregullore për llogaritë e arkëtueshme dhe provizionimin e borxheve. Do të promovohet më shumë mekanizmat e zhvilluar siç janë shërbimet e-commerce dhe pagesat online, si dhe marrëveshje me banka dhe institucione të tjera për lehtësimin dhe përshpejtimin e arkëtimit.

Në të njëjtën kohë, Kompania do të fokusohet në rritjen e të hyrave dhe zgjerimin e bazës së konsumatorëve, përmes identifikimit të industrive dhe subjekteve që shkarkojnë ujëra të ndotura në rrjetin e kanalizimit, si dhe përmes zgjerimit të faturimit pas marrjes në menaxhim të rrjeteve të kanalizimit në komunat e zonës së shërbimit. Fushatat informuese dhe vetëdijësuese do të përdoren për promovimin e pagesës së rregullt të shërbimeve dhe informimin e konsumatorëve për masat e ndërmarra nga Kompania.

Siguria e burimeve ujore do të mbetet prioritet, përmes sigurimit fizik dhe mbrojtjes së burimeve, monitorimit të tyre dhe identifikimit të burimeve të reja alternative. Veçanërisht do të hulumtohen burime të reja për zonën e Klinës, me synim rritjen e sigurisë së furnizimit me ujë të pijshëm dhe reduktimin e kostove të energjisë që lidhen me pompimin.

Në aspektin e investimeve kapitale dhe zhvillimit të infrastrukturës, Kompania do të orientojë të hyrat vetanake drejt investimeve në zonat me nevoja prioritare, me qëllim përmirësimin e furnizimit me ujë dhe shërbimeve të kanalizimit. Paralelisht do të synohen investime të përbashkëta me komunat dhe institucionet e nivelit qendror, si dhe mobilizimi i donacioneve dhe financimeve të jashtme për projektet e ujësjellësit, kanalizimit dhe efiçiencës së energjisë, përfshirë përdorimin e energjisë solare.

Në fushën e kanalizimit, prioritet do të jetë zgjerimi i rrjetit në zonat e pambuluara, në bashkëpunim me komunat e zonës së shërbimit, duke synuar rritjen e mbulueshmërisë, përmirësimin e shërbimeve dhe menaxhimin më të qëndrueshëm të ujërave të ndotura.

Në përgjithësi, këto masa synojnë reduktimin e humbjeve teknike dhe komerciale, rritjen e inkasimit, përmirësimin e efikasitetit operacional dhe financiar, sigurimin e burimeve të ujit, zgjerimin dhe rehabilitimin e infrastrukturës, si dhe ngritjen e cilësisë dhe qëndrueshmërisë së shërbimeve ndaj konsumatorëve.

5.2 Objektivi strategjik 1 — Zvogëlimi i humbjeve të ujit

Indikatori	**2027**	**2028**	**2029**
Humbjet e ujit	73%	71%	69%
Ujëmatës të mençur të instaluar	300	500	1000
Zëvendësimi i gypave të amortizuar	10 km	15 km	20 km
Frekuentues/SCADA të instaluar	10	15	20
Trajnime profesionale	5	7	9

Veprimet konkrete:

- Hartimi i strategjisë dhe planit të veprimit për zvogëlimin e humbjeve.
- Instalimi i ujëmatësve inteligjentë për lexim në distancë dhe ndërprerje automatike të furnizimit kur është e aplikueshme.
- Kontrolli sistematik shtëpi më shtëpi për identifikimin e kyçjeve ilegale.
- Menaxhimi i presionit përmes sistemeve SCADA dhe frekuentuesve.
- Zëvendësimi i gypave të amortizuar dhe sanimi i rrjetit.
- Trajnimi i ekipeve teknike për zbulimin e rrjedhjeve.
- Realizimi i fushatave vetëdijësuese për përdorimin racional të ujit dhe raportimin e defekteve/rrjedhjeve

Përgjegjësia dhe monitorimi: Përgjegjësia kryesore i takon Departamentit Teknik, ekipit për humbjet e ujit, njësive operative dhe inspektorëve, nën mbikëqyrjen e menaxhmentit. Monitorimi bëhet përmes treguesve të humbjeve, ujëmatësve, zonave DMA, raporteve të defekteve dhe raporteve periodike të performancës.

5.3 Objektivi strategjik 2 — Reduktimi i llogarive të arkëtueshme dhe rritja e inkasimit

Indikatori	**2027**	**2028**	**2029**
Rritja e normës së inkasimit	+10%	+12%	+15%
Zvogëlimi i llogarive të arkëtueshme	10%	15%	20%
Marrëveshje për pagesë me këste	+15%	+20%	+25%

Veprimet konkrete:

- Dërgimi i vërejtjeve dhe zbatimi i çkyçjeve sipas procedurave ligjore.
- Hartimi i planeve te leximit dhe shpërndarjes se rregullt te faturave
- Diversifikimi i formave të pagesave, qytetaret njoftohen për faturim, borxhe dhe pagesa
- Marrëveshje me bankat për lehtësimin e pagesave.
- Fushata informuese për pagesën e faturave dhe komunikim me konsumatorët përmes mediave.
- Trajtimi i borxheve të këqija, përfshirë procedurat me përmbarues privatë.
- Evidentimi dhe faturimi i industrive që shkarkojnë ujëra të ndotura.

Përgjegjësia dhe monitorimi: Përgjegjësia i takon Departamentit Komercial, Departamentit Financiar, inspektorëve, arkave dhe menaxhmentit. Monitorimi bëhet përmes normës së inkasimit, vlerës së llogarive të arkëtueshme, numrit të marrëveshjeve, pagesave online dhe raporteve mujore të faturimit e arkëtimit.

5.4 Objektivi strategjik 3 — Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit

Indikatori	**2027**	**2028**	**2029**
Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit	10%	15%	20%
Konsumatorë të rinj	3,000	3,000	3,000

Veprimet konkrete:

- Investime nga të hyrat vetanake në vlerë totale prej 1,643,200 € në kryerjen e punëve, furnizimi me materiale bazike për mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit si dhe për shërbime te ndryshme për ndërmarrjen te cilat përfshijnë renovimin e objekteve administrative, rehabilitimin dhe zgjerimin e rrjeteve të ujësjellësit, instalimin e ujëmatësve dhe pusetave, modernizimin e pajisjeve në ITUN, si dhe përmirësimin e infrastrukturës dhe objekteve përcjellëse në njësitë operative të kompanisë.

- Bashkëfinancim me komunat të cilat kapin shumen prej 495,000 € ku kompania do të investoj 60% ndërsa komunat 40% do jenë kryesisht projekte të përbashkëta për përmirësimin e infrastrukturës së vjetërsuar dhe zvogëlim të humbjeve në rrjet.
- Aplikim për fonde dhe donacione në vlerë totale prej 7,100,000 € me të cilat do të propozohen për financim tek aksionari dhe donatorët, me qëllim të rehabilitimit dhe modernizimit të infrastrukturës së ujësjellësit dhe kanalizimit, përmirësimit të kapaciteteve operacionale dhe rritjes së efikasitetit të shërbimeve.
- Investime në eficiencën energjetike duke shfrytëzuar financim nga projekti "Rezilienca Klimatike në Sektorin e Ujit (CRWSK)"
- Sigurim fizik i burimeve nga ndotja, dëmtimet dhe ndërhyrjet e paautorizuara.

Përgjegjësia dhe monitorimi: Zbatimi udhëhiqet nga Departamenti Teknik dhe njësitë operative, ndërsa monitorohet përmes kilometrave të rrjetit të ndërtuar, konsumatorëve të rinj dhe raporteve të projekteve.

5.5 Objektivi strategjik 4 — Zgjerimi i rrjetit të kanalizimit

Indikatori	**2027**	**2028**	**2029**
Zgjerimi i rrjetit të kanalizimit	10%	15%	15%
Konsumatorë të rinj	500	1000	1000

Veprimet konkrete:

- Bashkëpunim me komunat për zgjerimin e rrjetit të kanalizimit bazuar ne marrëveshje me komunat përkatëse
- Investime në ndërtimin e rrjete të reja;
- Identifikim i zonave prioritare pa shërbim dhe zgjerim i lidhjeve në ITUN.

Përgjegjësia dhe monitorimi: Përgjegjësia i takon Departamentit Teknik dhe njësive operative, ndërsa monitorimi bëhet përmes gjatësisë së rrjetit të ndërtuar, numrit të konsumatorëve të rinj dhe raporteve të zbatimit.

5.6 Objektivi strategjik 5 - Zhvillimi i burimeve njerëzore

Njësia	**Pozitat e planifikuara**	**Pjesëmarrja në trajnime dhe konferenca**
Pejë	➢ Inxhinier - 3 pozita ➢ Teknik i klorinimit - 1 pozitë ➢ Teknik laboratori - 1 pozitë ➢ Mirëmbajtës - 1 Pozitë	25 pjesëmarrës nga njësia
Klinë		5 pjesëmarrës nga njësia
Istog	➢ Mjeshtër për instalimin e ujëmatësve - 1 Pozitë ➢ Ndihmës mjeshtër – 1 pozitë	5 pjesëmarrës nga njësia
Deçan	➢ Bagerist - 1 Pozitë ➢ Ndihmës Mjeshtër - 1 Pozitë	5 pjesëmarrës nga njësia
Junik		3 pjesëmarrës nga njësia

Veprimet konkrete:

- Rishikimi i rregullores për sistematizim te vendeve te punës
- Organizimi i trajnimeve të brendshme – ad-hoc për fushat e nevojshme.
- Rishikimi i rregullores mbi pagat dhe kompensimet tjera.

- Hapja e konkurseve për plotësimin e pozitave te nevojshme për njësit.
- Trajnimi i stafit të rinj dhe njohja me detyrat dhe përgjegjësit;
- Aplikimi për pjesëmarrje në trajnime dhe konferenca brenda dhe jashtë vendit.
- Bashkëpunimi me shoqata dhe donator për ngritje te kapaciteteve të stafit

Plani i konkurseve:

Lloji i konkursit	Njësia operative	Pozita	Paga	Koha e rekrutimit
Konkurs i jashtëm	NJ.O Pejë	1. Inxhinier – 3 2. Teknik i klorinimit – 1 3. Teknik laboratori – 1 4. Mirëmbajtës - 1	1. 3 * 900 2. 1 * 540 3. 1 * 636 4. 1* 540	2027
Zëvendësimi personave qe dalin ne pension	NJ.O Pejë	1. Menaxher i kualitetit te ujit 2. Menaxher i Prokurimit 3. Lexues 4. Zyrtar për Asete 5. Shef i mirëmbajtjes se pompave	1. 1* 1068 2. 1 * 1116 3. 1 * 660 4. 1 * 780 5. 1* 756	1. 25.01.2025 2. 30.04.2027 3. 02.05.2027 4. 12.06.2027 5. 11.11.2027
Konkurs i jashtëm	Nj.O Istog	1. Mjeshtër për instalimin e ujëmatësve - 1 2. Ndihmës mjeshtër – 1	1. 1* 660 2. 1* 588	Mars 2027
Zëvendësimi personave qe dalin ne pension	NJ.O Istog	1. Inxhinier 2. Shef i shërbimit te operimit dhe mirëmbajtjes se Ujësjellësit 3. Arkatare	1. 1*900 2. 1* 756 3. 1* 732	1. 01.04.2027 2. 25.04.2027 3. 01.09.2027
Konkurs i jashtëm	NJ.O Deçan	1. Ekskavatorist – 1 2. Ndihmës mjeshtër – 1	1. 1* 660 2. 1* 588	Mars 2027
Totali për pozita të reja për vitin 2027			**83,000 Euro**	

Përgjegjësia dhe monitorimi:

Përgjegjësia i takon zyrës për burime njerëzore se bashku me menaxhmentin, ndërsa monitorimi bëhet përmes numrit e konkurseve te hapura dhe numrit te pjesëmarrësve në trajnime dhe konferenca.

6. Performanca 2026 dhe planifikimi 2027

Gjatë vitit 2026, KRU “Hidrodrini” Sh.A. ka zhvilluar aktivitete në përmbushje të projekteve të financuara nga partnerët ndërkombëtarë dhe institucionet publike, si dhe në përmirësimin e matjes, furnizimit dhe trajtimit të ujërave.

- Përmbushja e kritereve të përcaktuara nga Qeveria Gjermane dhe Zyra Zvicerane për projektet Kosova IV, V dhe VI.
- Fushatë në shkolla për vetëdijesimin e nxënësve për moshedhjen e letrave të lagura në rrjetin e kanalizimit.
- Instalimi i 37 ujëmatësve dhe 36 data loggerëve për monitorimin në distancë dhe në kohë reale të prodhimit të ujit në burimet kryesore.
- Zbatimi i projektit të SECO-s për qëndrueshmërinë klimatike në sektorin e ujit në Kosovë, me investim prej 100,000.00 eurosh.
- Ndërtimi i fundërruesit në Klinë, si bashkëinvestim me Qeverinë e Republikës së Kosovës, Komunën e Klinës dhe KRU “Hidrodrini” Sh.A.
- Ndërrimi i ultrafiltrave në fabrikën e ujit në Klinë.
- Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit dhe stacionit të pompave për fshatrat Poqestë, Ramun, Zahaq dhe Gorazhdevc.
- Përfundimi i projektit të rrjetit të kanalizimit të financuar nga Qeveria Gjermane, për projektet Kosova V dhe VI.


6.1 Performanca operative dhe financiare

Treguesi	2023 – Real	2024 – Real	2025 – Real	2026 – Real	2027 – Parashikim	%
Prodhimi (m^3)	38,641,481	47,460,695	47,177,923	47,214,365	47,686,508	+1%
Faturimi (m^3)	9,953,074	9,922,574.66	10,329,070	11,361,977	12,875,357	+11.75 %
Faturimi Euro	4,366,759.97€	4,552,215.67€	5,045,482.84€	6,565,787 €	7,041,902 €	+6.76%
Humbjet	74%	82%	78%	75%	73%	+3%
Shpenzimet	3,510,492.59 €	3,774,584.90 €	4,199,742.17 €	4,913,698.34 €	5,696,996 €	+20%
Inkasimet me TVSH	3,733,100.27 €	4,062,962.97 €	4,476,137.76 €	5,940,630.89€	6,600,700.99€	+10 %

Tabela 1. Prodhimi, faturimi, humbjet, shpenzimet dhe inkasimi 2023–2027.

7. Burimet ujore, infrastruktura dhe tarifat

Kompania shfrytëzon 22 burime ujore dhe mbështetet edhe nga fabrika ose Impianti i përpunimit ujit të pijes në Klinë, ku gjatë vitit 2024 fabrikës së përpunimit të ujit në Klinë i është shtuar edhe Fundërruesi i cili bënë pastrimin e ujit para filtrimit, më poshtë paraqiten vendburimet ujore, statistikat prodhuese etj:




Fotografia 7. Zona e shërbimit të KRU "Hidrodrini" Sh.A. – Burimet e ujit

Burimet janë evidentuar sipas emërtimit, koordinatave, vendndodhjes, tipit dhe kapacitetit.


Nr.	Nj.O.	Burimi	Pika Trajtuese	Ujëmatës i prodhimit
1	Deçan	Deçan	Deçan	Deçan - te objekti
2	Deçan	Rakita dhe Gurrat e Bardha	Strellc	Strellc i Epërm
				Strellc i Poshtëm
3	Deçan	Kurvalla dhe Hasanaga	Kurvalla dhe Hasanaga	Ujëmatësi i 10 fshatrave
4	Deçan	CDF	CDF	Ujëmatësi i CDF
5	Deçan	Isniq	Isniq	Ujëmatësi i Isniqit
6	Istog	Vojdullë dhe Kosharishtë	Shushicë	Burimet e Vojdollit dhe Kosharishtës 1
				Burimet e Vojdollit dhe Kosharishtës 2
				Burimet e Vojdollit dhe Kosharishtës 3
				Burimet e Vojdollit dhe Kosharishtës 4
7	Istog	Istog	Istog	Burimi i Istogut 1
				Burimi i Istogut 2
				Burimi i Istogut 3
				Burimi i Istogut 4
8	Istog	Javor	Zhakovë	Burimi i Javorit
9	Istog	Vrellë	Vrellë	Burimi i Vrellës 1
				Burimi i Vrellës 2

				Burimi i Vrellës 3
				Burimi i Vrellës 4
				Burimi i Vrellës 5
				Burimi i Vrellës 6
10	Junik	Shkozë	Shkozë	Burimi i Shkozës
11	Junik	Goç	Goç	Burimi kryesor
12	Klinë	Garabil	Garabil	Burimi i Garabilit
13	Klinë	FTU	FTU	Fabrika
				Pusi i Videjes
14	Klinë	Jarina	Jarina	Jarina 1
				Jarina 2
				Jarina 3
15	Klinë	Kpuz	Kpuz	Puset e Kpuzit
16	Klinë	Berkovë	Berkovë	Pusi i Berkoves
17	Klinë	Rastoka	Rastoka	Pusi i Rastokes
18	Klinë	Volljak	Volljak (nuk trajtohet)	Pusi i Volljakut
19	Pejë	Drini i Bardhë	Drini i Bardhë	Burimi i Radavcit
20	Pejë	Raushiq	Raushiq	Burimi i Raushiqit
21	Pejë	Uji i Bardhë	Uji i Zi	Burimi i Ujit të Bardhë
22	Pejë	Uji i Zi		Burimi i Ujit të Zi

Tabela 2. Burimet e ujit



Fotografia 8. Zona e shërbimit të KRU "Hidrodrini" Sh.A. – Burimet e ujit 2



Fotografia 9. Rrjeti i kanalizimit i ndarë në bazë të kolektorëve

7.1 Rrjeti dhe mbulueshmëria

KRU “Hidrodrini” Sh.A. menaxhon rreth 1,302 km rrjet të ujësjellësit dhe rreth 514 km rrjet të kanalizimit. Rrjeti i kanalizimit në shumë raste është i përzier me kanalizimin e ujërave atmosferike. Kompania kryen pastrimin, zhbllokimin dhe sanimin e defekteve, bllokimeve dhe pengesave në kolektorë. Në vitin 2024 është marrë nën shërbim edhe mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit në bashkëpunim me komunat e zonës së shërbimit.

Njësia	**Rrjeti i ujësjellësit**	**Rrjeti i ujësjellësit i digjitalizuar**	**Digjitalizimi**
Pejë	467 km	467 km	100%
Istog	344 km	344 km	100%

Deçan	186 km	186 km	100%
Klinë	264 km	264 km	100%
Junik	41 km	41 km	100%
Totali	1,302 km	1,302 km	100%

Tabela 3. Gjatësia e rrjetit të ujësjellësit sipas njësive.

Kategoria e aseteve	**Databaza e KRU-së**	**Asete të vlerësuara sipas PMA**	**Vlerësimi**
Fabrikat e përpunimit të ujit	1	1	100%
Stacionet e pompimit	41	41	100%
Rezervuarët e ujit	28	28	100%
Burimet e ujit	29	29	100%
Impianti për trajtimin e ujërave të ndotura	1	1	100%

Tabela 4. Asetet jo-infrastrukturore të KRU-së.

Njësia	Rrjeti i kanalizimit	Rrjeti i digjitalizuar në GIS	Digjitalizimi
Pejë	211 km	211 km	100%
Istog	93 km	93 km	100%
Deçan	48 km	48 km	100%
Klinë	138 km	138 km	100%
Junik	24 km	24 km	100%
Totali	514 km	514 km	100%

Tabela 5. Gjatësia e rrjetit të kanalizimit sipas njësive

Mbulueshmëria me ujë të pijshëm është raportuar 91%, me rreth 202,564 banorë të shërbyer nga 220,338 banorë gjithsej dhe 168 vendbanime të shërbyera nga 223. Mbulueshmëria me rrjet kanalizimi është 69%, me rreth 155,934 banorë të shërbyer; trajtimi i ujërave të ndotura mbulon 45% të popullsisë me kanalizim ose 31% të popullsisë së përgjithshme. Shërbime kanalizimi ofrohen në 107 nga 223 vendbanime.

7.2 Tarifat e shërbimit për vitin 2027

Kategoria	Ujësjellës (€/m³)	Ujërat e ndotura (€/m³)
Shtëpiak	0.4160	0.1622

Jo-shtëpiak, komercial dhe institucional	0.4992	0.3083

Tabela 6. Tarifat volumetrike për vitin 2027

Diametri ose kategoria	**Tarifa fikse mujore (€)**
Vetëm lidhje e ujërave të ndotura	0.6915
15 mm dhe 20 mm	1.3830
25 mm dhe 32 mm	2.2127
40 mm dhe 50 mm	8.9615
65 mm dhe 80 mm	22.1272
100 mm dhe 125 mm	27.2165
150 mm dhe 200 mm	42.9268
250 mm	59.7435

Tabela 7. Tarifa fikse mujore sipas diametrit të lidhjes.

Shërbimi	**Tarifa**
Ndërprerja e përkohshme e lidhjes	10.00 €

Ndërprerja e përhershme e lidhjes	20.00 €
Ri-lidhja pas ndërprerjes së përkohshme	10.00 €

Tabela 8. Tarifat për inspektim, ndërprerje dhe ri-lidhje

Diametri	**Pa pusetë (€)**	**Me pusetë, pa asfaltim (€)**	**Totale (€)**
15–20 mm	80.00	240.00	490.00
25 mm	100.00	260.00	510.00
32 mm	140.00	300.00	550.00
40 mm	180.00	340.00	590.00
50 mm	370.00	530.00	780.00
65–75 mm	490.00	650.00	900.00
80 mm	625.00	785.00	1,035.00
100 mm	780.00	940.00	1,190.00

Tabela 9. Tarifat për realizimin fizik të lidhjes në rrjetin e ujësjellësit.

Diametri i gypit të kanalizimit	**Pa pusetë (€)**	**Me pusetë, pas asfaltimit (€)**	**Totale (€)**

160 mm	26.00	153.00	403.00
200 mm	36.00	163.00	413.00
250 mm	46.00	173.00	423.00
315 mm	76.00	203.00	453.00

Tabela 10. Tarifat për realizimin fizik të lidhjes në rrjetin e kanalizimit.

Diametri i ujëmatësit	**Tarifa e testimit (€)**
20 mm, 25 mm dhe 32 mm	16.50
40 mm, 50 mm dhe 63 mm	18.00
75 mm, 90 mm dhe 110 mm	19.00

Tabela 11. Testimi i ujëmatësit për sigurinë e matjes

Nr.	**Diametri**	**Ujësjellësi pa TVSH**	**Kanalizimi pa TVSH**	**Totali pa TVSH**
1	15	37.71	7.31	45.02
2	20	37.71	7.31	45.02
3	25	37.71	7.31	45.02
4	32	39.86	7.73	47.58
5	40	62.28	12.07	74.35
6	50	97.31	18.86	116.17
7	65	164.45	31.88	196.33

8	80	249.11	48.29	297.40
9	100	389.23	75.45	464.69
10	125	608.18	117.90	726.07
11	150	875.78	169.77	1,045.55
12	200	1,138.51	220.70	1,359.21
13	250	1,480.06	286.91	1,766.97

Tabela 12. Tarifa e mbingarkesës së infrastrukturës, e zbatueshme nga 01 janar 2027 sipas letrës zyrtare të ARRU-së nr. prot. 7161/D, datë 20.10.2026

8. Impiantet e ujit të pijshëm dhe trajtimi i ujërave të ndotura

8.1 Impianti i Trajtimit të Ujit të Pijshëm dhe fundërruesi — Klinë

Impianti në Klinë është investim i Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Komunës së Klinës. Punimet kanë përfunduar në mars 2013, ndërsa impianti është lëshuar në përdorim në shkurt 2015. Procesi është i automatizuar përmes kontrollit PLC Siemens Simatic S7. Uji kalon në mikrofiltra me disqe prej 10 mikrometrash dhe më pas në ultrafiltra polimerikë me nivel filtrimi deri në 0.01 mikrometra.



Fotografia 10. Pamje e ITUP në Klinë

Komponentët kryesorë janë marrja e ujit nga Drini i Bardhë dhe puset, filtrimi fillestar, ultrafiltrimi, sistemi i vetëpastrimit, pastrimi me klor, rezervuarët, stacionet e pompimit deri në 160 kW dhe klorinimi. Kapaciteti maksimal i projektuar është 83 l/s.



Fotografia 11. Pamje e brendshme e ITUP në Klinë

Impianti furnizon qytetin e Klinës dhe disa fshatra. Për shkak të ndotjes së filtrave është planifikuar ndërrimi i tyre dhe rritja e kapacitetit të prodhimit. Në nëntor 2025 është vënë në funksion fundërruesi me vlerë investimi 850,000.00 euro, i cili kryen parafiltrimin dhe mundëson filtrimin deri në 80 l/s për qytetin dhe rrethinën e Klinës.



Fotografia 12. Fundërruesi

8.2 Impianti i Trajtimit të Ujërave të Ndotura — Pejë

Ujërat e ndotura trajtohen në ITUN në Pejë, përkatësisht në fshatin Gorazhdec, ujërat e ndotura që derdhën në këtë impiant, përbëhen nga ujërat e ndotura shtëpiake, tregtare dhe industriale (Fabrika e "Birra Peja", hirra e Fabrikës "Rugove" etj). Këto mblidhen nga një kanalizim i ri kryesor, i cili është ndërtuar në të njëjtën kohë.

Komponentët kryesorë të këtij projekti janë:

a) Një ITUN me një kapacitet prej 81,000 ekuivalentë të popullsisë (Banor Ekuivalent);
b) Në fazën e dytë të projektit në vitet e ardhshme përshihet investimi në adaptimin e impiantit për 96,000 Banor Ekuivalent nga BE;
c) Tani më ekzistues është kanalizimi prej rreth 7.615 km në total dhe objektet e lidhura;
d) Në këtë fazë janë vetëm rreth 5 ha të terrenit, dhe 9.84 ha për të operuar objekti dhe për të arritur standardet përkatëse të trajtimit. Pjesa tjetër prej 4,84 ha janë e mjaftueshme për të akomoduar njësi të procesit shtesë në Fazën e II-të të projektit;

e) Ekzistojnë pesë (5) seksione të koleksionistëve kryesor nga pikat ekzistuese të shkarkimit D2, D4, D5 dhe D6 në rrjetin e transmisionit. Gjatësia totale: 4,015m;

f) Gjersa janë dy (2) seksione të rrjetit të transmisionit (MC1.1 dhe MC1.2). Gjatësia totale: 2.305 m;

g) Janë dy (2) seksione të gypave të presionit të lidhur për fshatin Gorazhdec dhe aglomeratet ngjitur në ITUN. Gjatësia totale: 1.295 m;



Fotografia 13. Pamje nga lartë e ITUN në Pejë

8.3 Fazat e trajtimit

Trajtimi i ujërave të ndotura komunale në ITUN Peja kalon nëpër disa faza të cilat do të paraqiten si me poshtë:

1. Trajtimi parësor: Faza e trajtimit parësor përfshinë ndarjen fizike të materialeve të ngurta nga ujërat e ndotura. Kjo zakonisht bëhet duke përdorur rrjeta ndarëse dhe rezervuar sedimentimi për të hequr mbeturinat e mëdha dhe lëndët e ngurta të vendosura.
2. Trajtimi sekondar: Impianti i trajtimit të ujërave të ndotura komunale në Pejë përbën një kombinim të proceseve aerobike dhe anaerobe, sa i përket trajtimit dytësor trajtimin aerobik: e cila arrihet përmes llumit të aktivizuar. Në sistemet e llumit të aktivizuar, mikroorganizmat shtohen në ujërat e ndotura për të zbërthyer lëndën organike dhe përzierja ajroset për të nxitur rritjen e tyre.
3. Trajtimi anaerobik: Tretja anaerobe është një proces ku mikroorganizmat shpërbëjnë lëndën organike në mungesë të oksigjenit. Kjo është pjesë e procesit të trajtimit të llumit të krijuar në fazat e trajtimit parësor dhe dytësor. Tretja anaerobe në rastin tonë prodhon biogaz si nën produkt, i cili përdoret për prodhim të rrymës elektrike.
4. Dezinfektimi: Pas fazave të trajtimit dytësor dhe terciar, efluenti dezinfektohet për të vrarë çdo patogjen të mbetur, në rastin tonë janë të vendosur UV rrezatim.

5. Menaxhimi i llumit: Llumi i prodhuar gjatë procesit të trajtimit (si primar ashtu edhe sekondar) depërtohet dhe trajtohet për të zvogëluar volumin e tij dhe për të hequr patogjenët. Biosolidet që rezultojnë mund të përdoren në bujqësi ose të asgjësohen në mënyrë të kontrolluar.
6. Shkarkimet e rrjedhës: Ujërat e ndotura të trajtuara, tani të quajtura efluent, zakonisht shkarkohen në Lumbardh, ose ripërdoren për qëllime jo të pijshme.
7. Pajtueshmëria me mjedisin: Impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura komunale duhet t'u përmbahen rregulloreve strikte mjedisore për të siguruar që efluenti i trajtuar të jetë i sigurt për mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

8.4 Aspektet operacionale

Përshkrimi i procesit të trajtimit të llumit përbëhet nga një proces i tretjes anaerobe (këtu është tretja mezofilike), njësia e kombinimit të nxehtësisë dhe energjisë për rikuperimin e energjisë së biogazit të gjeneruar, tretjes mekanike të llumit nga centrifuga dhe zona e deponimit të llumit. Vendimi për procesin e tretjes së propozuar u bazua në një analizë të opsioneve (aerobik dhe anaerobike) të përgatitura nga Konsulenti Implementues (Dahlem) duke marrë parasyesh aspektet energjetike, konstruktive dhe të efikasitetit të kostos. Ekziston një kontenier trajtues (digester) anaerob mesofilik të dimensionuar për një kohë mbajtjeje prej 21 ditësh me një volum prej rreth 2,200 m3.



Fotografia 14. Pamje nga lartë i ITUN në Pejë - 2

Kontenieri trajtues operon 37 ° C. Shkëmbyesi i nxehtësisë, pompat e ri-qarkullimit, njësitë dhe trajtimi i gazit është i vendosur në një ndërtesë ngjitur me makineritë. Procesi i tretjes dhe prodhimi i biogazit reduktojnë përmbajtjen organike të llumit. Kjo qon në zvogëlimin e vëllimit të llumit dhe patogjenëve. Duke reduktuar përmbajtjen organike të llumit, ujërat e zeza përmirësohen ndjeshëm. Drenazhimi mekanik i llumit me centrifugë është propozuar për të zvogëluar volumin e llumit dhe për të rritur përmbajtjen e materieve të ngurta në 20%. Pas heqjes mekanike llumi do të ruhet në një depo të caktuar (sipërfaqja: 750 m²). Nga ky objekt i mbuluar llumi mund të përpunohet më tej për opsionet e ripërdorimit ose të deponimit të caktuar.

---

9. Departamenti Teknik dhe GIS

9.1 Roli dhe organizimi

Departamenti Teknik planifikon, projekton, ndërton dhe mirëmban sistemet e ujësjellësit, kanalizimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura. Ai monitoron performancën e rrjetit,

identifikon defektet, planifikon ndërhyrjet, redukton humbjet dhe siguron përmbushjen e standardeve teknike, mjedisore dhe të shëndetit publik.

Divizioni	**Funksionet kryesore**
Furnizimi me ujë të pijshëm	Mirëmbajtja dhe operimi i rrjetit, stacioneve të pompimit, rezervuarëve dhe impiantit të ujit të pijshëm.
Ujërat e ndotura	Mirëmbajtja dhe operimi i rrjetit të kanalizimit.
ITUN	Mirëmbajtja dhe operimi i impiantit, menaxhimi i llumit dhe laboratori i ITUN-it.
Planifikimi dhe zhvillimi	Menaxhimi i UPF/DMA, GIS-it, aseteve, investimeve dhe projekteve.

Tabela 13. Divizionet dhe Funksionet kryesore te departamentit teknik

9.2 Objektivat teknike

- Identifikimi i kërkesave infrastrukturore duke marrë parasysh rritjen dhe zhvillimin e zonës së shërbimit.
- Planifikimi i investimeve sipas projeksioneve demografike, zhvillimore, kërkesave rregullatore, ndryshimeve klimatike dhe vjetërsisë së infrastrukturës.
- Sanimi i shpejtë i defekteve për reduktimin e humbjeve, kostove dhe rrezikut të ndotjes.

Kompania është e përkushtuar për ndërmarrjen e të gjitha aktiviteteve investive dhe operative me qëllim të krijimit të një infrastrukture të konsoliduar të ujësjellësit dhe kanalizimit, në interes të ofrimit të shërbimeve cilësore për konsumatorët e vet, jo vetëm sot por edhe në të ardhmen.

9.3 Prodhimi i Ujit

Zona e shërbimit të KRU “Hidrodrini” shtrihet në pesë komuna, të cilat janë:

1. Komuna e Pejës,
2. Komuna e Istogut,
3. Komuna e Klinës,
4. Komuna e Deçanit dhe
5. Komuna e Junikut.

Për secilën nga këto komuna ka pika të veçanta prej nga merret uji, trajtohet, duke i plotësuar standardet sipas ligjeve në fuqi, dhe pastaj u dërgohet konsumatorëve për pije.

Bazuar në legjislacionin në fuqi, në secilën nga këto pika ku merret ujit, janë vendosur ujëmatës përkatës të cilët bëjnë matjen e saktë të sasisë së ujit që futet në sistemin e rrjetave të ujësjellësve të njësive përkatëse.

9.4 Defektet në rrjetin e ujësjellësit

Gypat e ujësjellësit luajnë një rol kyç në shpërndarjen e ujit të pijshëm, dhe çdo defekt në sistem mund të rezultojë në humbje të mëdha, ndotje të ujit dhe rrezik për shëndetin e publikut. Sanimi i shpejtë dhe efikas i defekteve ndihmon në minimizimin e humbjeve të ujit, reduktimin e kostove operative dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve.

Përveç kësaj, ndërhyrjet e rregullta në sistemin e ujësjellësit janë të domosdoshme për të garantuar që infrastruktura të qëndrojë e qëndrueshme dhe e aftë për të përballuar kërkesat në rritje për ujë, duke mbrojtur kështu burimet natyrore dhe ambientin. Prandaj, investimi në sanim dhe mirëmbajtje të gypave është një përparësi strategjike për KRU-në që kërkon të sigurojë një furnizim të sigurtë dhe cilësor me ujë.


KRUH i kushton një rëndësi të madhe sanimit të shpejtë të defekteve në sistemin e ujësjellësit, e cila është një nga aktivitetet kryesore të saj. Angazhimi për zgjidhjen e menjëhershme të çdo problemi garanton që furnizimi me ujë të mbetet i pandërprerë dhe i sigurt për konsumatorët. Me një ekip të specializuar dhe teknologji të avancuara, kompania synon të reduktojë ndjeshëm kohën e ndërhyrjes, duke minimizuar kështu humbjet e ujit dhe duke përmirësuar efikasitetin operacional. Kjo qasje pro aktive, jo vetëm që rritë cilësinë e shërbimeve, por gjithashtu ndihmon në ruajtjen e burimeve natyrore, duke kontribuar në një menaxhim më të qëndrueshëm të ujit.

Tabelari më poshtë tregon kohëzgjatjen e riparimit në bazë të diametrave për kushte normale, ka shumë faktorë të tjerë që ndikojnë në zgjatjen e kohës së riparimeve.


Diametri i gypit	**Kohëzgjatja normale e riparimit**
20–40 mm	60 minuta
50–90 mm	90 minuta

110–160 mm	120 minuta
200–315 mm	180 minuta
350–500 mm	240–300 minuta

Tabela 14. Kohëzgjatja e riparimit në bazë të diametrave



Fotografia 15. Rrjeti i ujësjellësit sipas diametrit në të gjithë zonën e shërbimit të KRUH



Fotografia 16. Rrjeti i kanalizimit në të gjithë zonën e shërbimit të KRUH

9.5 Sektori i GIS-it


Sektori i GIS-it incizon rrjetin e ujësjellësit, rrjetin e kanalizimit, rrjetin atmosferik, konsumatorët, sistemin e adresave dhe defektet. Ai krijon dhe mirëmban hartat dhe aplikacionet në ArcGIS Online. Të dhënat për materialin, diametrin, vitin e instalimit, defektet, pusetat, ujëmatësit, valvulat dhe hidrantët ruhen në bazën e të dhënave të GIS-it, e cila është e ndërlidhur me faturimin, depon dhe CRM-in.

Vlerësimi i aseteve infrastrukturore bëhet duke përdorur materialin, diametrin, vitin e instalimit, jetëgjatësinë e mbetur, defektet për kilometër dhe kritikalitetin e gypave. Platforma ArcGIS Desktop përdoret që nga viti 2010, ndërsa ArcGIS Pro dhe ArcGIS Online për publikimin e të dhënave.


